



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.341/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Milena Đerić dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi-Pireva duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN dhe Internews, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 14 Shkurt 2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 08.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e BIRN dhe Internews, ndërsa subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 4,000.00 (katër mijë) euro, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, me rastin e promovimit të subjektit politik dhe kandidatit të këtij subjekti, duke e shfrytëzuar burimet e institucionit-zyrës së Ministrisë të Bujqësisë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me qëllim të përfimit elektoral, në fushatë zgjedhore, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen me datë 14.02.2021.

II. Detyrohet Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, nën kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë.

A r s y e t i m

BIRN dhe Internews, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 04.02.2021, me të cilën pretendon se kandidati për deputet nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës-LDK, Besian Mustafa, me datën 04.02.2021 në ora 16:23 rrjetin e saj social facebook ka publikuar një video përmes së cilës ka bërë thirrje për ta votuar .Mirëpo me rastin e përgatitjes së kësaj video i njëjti ka përdorur asetet publike, gjë e cila është e ndaluar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Në videon e publikuar shihet Ministri në detyrë Besian Mustafa duke folur për të arriturat e tij si Ministër, ndërsa në fund të videos shfaqet Sllogani Shteti Shtet, fotografia, emri e mbiemri i tij dhe me numrin 13 në listën e kandidatëve të subjektit politik LDK. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur dy fotografi nga hapësirat e zyrës së tij si dhe sekuenca nga video inqizimi.

Subjekti politik LDK, në përgjigjen në ankesë të datës 05.02.2021, theksoi se ankesa e bërë ndaj tyre nuk është e bazuar pasi që pretendimet e tyre për shkeljen e nenit 35.1 i LZP-së nuk qëndrojnë, ngase kandidati për deputet nga subjekti politik LDK, Besian Mustafa për videon e për të cilën është ngritur në ankesë, nuk ka përdorur asetet publike apo ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave.

Më tej në përgjigje në ankesë shtojnë se ambientet e punës së Besian Mustafës janë të shumta e sidomos në kohën e fushatës duke u nisur nga fakti se ai ushtron detyrën e zëdhënësit të LDK-së dhe anëtarit të Shtabit Qendror të kësaj partie dhe se video e realizuar nuk ka qenë në ambientet e zyrës së tij si ministër siç pretendon ankuesi, por nga zyrat e partisë ku i njëjti ushtron role të ndryshme dhe të shumta.

Më tutje subjekti politik LDK, deklaroi se janë marrë masa përmirësuese, ku është evituar shkelja duke larguar nga llogaria e tij në rrjetin social facebook videon e publikuar, dhe kjo dëshmohet me fotografitë e bashkangjitura në përgjigje.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se Organizata BIRN dhe Internews Kosova me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë PZAP A.nr 341/2021 më datë 04.02.2021, me të cilën pretendon se kandidati për deputet nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Besian Mustafa, me datën 03.02.2021 në ora 02:15 rrjetin e tij social facebook ka publikuar një video përmes së cilës ka bërë thirrje për ta votuar. Pas pranimit të ankesës në PZAP, e njëjta i është dërguar subjektit politik LDK për përgjigje në ankesë.

Subjekti politik LDK me datë 05.02.2021, ka paraqitur përgjigje në ankesë, duke i kundërshtuar në tersi pretendimet e ankuesit të parashtruara në ankesë dhe duke kërkuar që ankesa të refuzohet e pa bazuar.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se kandidati Besian Mustafa me qëllim të promovimit të subjektit të tij politik dhe vetvetes përmes spotit publicitar duke shfrytëzuar hapsirat-zyret e Ministrit të Bujqësisë pra asetet publike ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Kandidatët dhe Mbështetësit neni 35.1 e LZP-së, ku parashihet se *“Personi i cili mbanë pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj për qëllim të përfitimit të votave...”* duke bërë publik emrin e tij me numrin në listën zgjedhore të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, gjë e cila është veprim i ndaluar sipas LPZ-së.

Përdorimi i asetëve publike, çoftë zyre, apo objekte tjera, me qëllim përfitimi elektoral, nënkupton shfrytëzim të pasurisë në fjalë në kundërshtim me dedikimin e tyre, meqenëse

pasuria apo asetet në fjalë janë të Shtetit të Republikës së Kosovës, të mbrojtura nga tendenca e përdorimit të tyre për përfitime personale. Të njëjtat janë në posedim dhe shfrytëzim nga ana e personave në fjalë vetëm gjatë kohës së ushtrimit të funksionit/mandatit pasi janë të lidhura me funksion/mandat, si dhe me përfundimin e funksionit apo mandatit humbet e drejta e shfrytëzimit të tyre.

Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Nuk qëndron pretendimi si në përgjigje në ankesë se vendi ku është xhiruar videoja është zyre e LDK-së, pasi subjekti në fjalë nuk ka ofruar asnjë dëshmi bindëse për këtë por tenton që vetëm për shkak të fotografisë së heroit Gjergj Kastrioti që shihet vendosur në mure mbrapa kandidatit në fjalë të bëjë ndërlidhjen me foton e njëjtë që gjinden edhe në një pjesë të objektit të zyrave të subjektit në fjalë, pasi që në video nuk shihet asnjë flamur partiak apo shenjë identifikuese e partisë, por paneli vlerëson se videoja në fjalë është xhiruar në objektin e zyrës së Ministrisë të Bujqësisë.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se kandidati për deputet nga radhët e këtij subjekti, Besian Mustafa, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës. Paneli ka marrë parasysh po ashtu edhe përgjigjen në ankesë të subjektit politik LDK, ku theksohet se video incizimi është larguar nga rrjeti social facebook, si dhe me rastin e hetimit të facebook-ut të kandidatit në fjalë nuk ka hasur në video spotin për të cilin i është shqiptuar gjoba, andaj kjo i është vlerësuar ndërmarrje e veprimeve përmirësuese, e cila ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin jo relevante dhe pa ndikim për një vendimmarrje ndryshe nga ajo që është vendos.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ *120.2 Dëshimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një*

shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.341/2021 me datën 08.02.2021

Kryesuesi i Panelit
Faton Ademi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së